VENDIM
Nr. 230, datë 26.10.2018

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "SGD ENERGJI" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "NDËRFUSHAS", ME FUQI TË INSTALUAR 1125 kw, ME VENDNDODHJE NË ZONËN E BULQIZËS

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe të nenit 4, pika 1, germa "a"; të nenit 5, pika 1, germa "a"; të nenit 8, pika 2 dhe të nenit 10, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "SGD Energji" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Ndërfushas", me fuqi të instaluar 1125 kw dhe vendndodhje në zonën e Bulqizës,

konstatoi se:

- Shoqëria "SGD Energji" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 655 prot., datë 17.10.2018, ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Ndërfushas", me fuqi të instaluar 1125 kw dhe vendndodhje në zonën e Bulqizës, për një periudhë 49-vjeçare.

- Aplikimi i shoqërisë "SGD Energji" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1): plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c"): plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5): plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni i munguar ka të bëjë me:

- Vërtetimet nga Gjykata dhe Prokuroria (neni 9, pika 2, germa "d");

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a" (Vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave); "b" (Paraqitje bilanci financiar të tri viteve të fundit); "c" (Dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit) dhe "d" (Vërtetimin e pagesës së aplikimit në llogari të ERE-s).

- Mungesën e kryerjes së pagesës së aplikimit për licencim përbën një element thelbësor për mosfillimin e procedurës së licencimit.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "SGD Energji" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Ndërfushas", me fuqi 1125 kw, me vendndodhje në zonën e Bulqizës.

2. Subjekti mund të paraqesë brenda 30 ditëve një aplikim të ri, sipas nenit 10, pika 7, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti